

## FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI

E ENJTE 14 PRILL 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot jemi këtu për të diskutuar projektligjin “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to”. Gjatë seancave maratonë të dëgjësive për këtë projektligj duhet thënë se qeveria nuk resht së na mahnituri me mungesën e sinqeritetit dhe të përgjegjësisë. Ishin përfaqësuesit e ministrisë, të cilët tregonin se kishin zhvilluar seanca dëgjimore me të gjitha grupet e interesit, ndërkohë që agjencitë, të cilët janë pjesë e këtyre grupeve të interesit, shpreheshin se kjo nuk ka ndodhur. Njëherë ministria thoshte se agjencitë nuk janë grupe interesi, por janë artistët, të cilët kundërshtonin se kishin zhvilluar seanca dëgjimore.

Ky projektligj ka në bazë të tij dy pjesë: pjesa e parë i dedikohet përafrimit të bazës ligjore me direktivat e BE-së, ndërsa pjesa e dytë përbëhet nga ndryshimet ligjore, të propozuara nga ministria, të cilat janë kontestuar nga agjencitë. Nisur nga ky fakt ne kuptojmë mënyrën se si operojnë këto institucione. Ka pasur kontestime dhe shpeshherë debate për pika të caktuara, të cilat u morën në shqyrtim për ndryshim pas disa insistimesh, por sot ende nuk kanë asnjë ndryshim, për më tepër kanë edhe problematika. Personalisht jam dhe gjithmonë do të jem parimisht pro çdo ligji, që u risjell artistëve dinjitetin e humbur gjatë viteve; pro çdo nisme, që flet për të drejtat e autorëve dhe gazetarëve dhe ne, si deputetë, duhet të bëjmë më shumë për ta. Por sot, fatkeqësisht, nuk është ky rasti, situata është krejt ndryshe. Po jetojmë një realitet të hidhur; familjet shqiptare po varfërohen çdo ditë e më shumë, mjafton të pyesim vetëm familjet e Fushë Krujës në Nikël apo Bupq për situatën ku ndodhen. Fermerët pohojnë se nuk do të marrin asnjë iniciativë të investojnë në bujqësi, sepse çmimet janë rritur dhe nuk mund të punojnë as në arat e tyre. Bizneset e të gjitha kategorive paguajnë taksa marramendëse edhe pse ka mungesë të energjisë elektrike.

Të dashur qytetarë, varfëria ka kapluar vendin, ndërsa kjo qeveri del me disa vendime thujse qesharake, si “Paketa e rezistencës”, duke na thënë se, nëse një familje paguhet 120 euro në muaj nuk mund quhet e varfër. Por në cilin vend e keni dëgjuar këtë? Si mund të dilni para qytetarëve duke insistuar për këto deklarata? Ato subvencione nuk arrijnë të mbulojnë as rritjen e çmimit të bukës. Këni shkatërruar ekonominë e këtij vendi; po dëmtoni çdo ditë xhepat e qytetarëve. Na tregoni se keni qeverisur me sukses, se e keni përballuar krizën energjetike me buxhetin e shtetit dhe harroni se ka nga ata qytetarë, të cilët janë vetërrarë për shkak se e kanë pasur të pamundur të paguanin çmimin e lartë të energjisë elektrike nën qeverisjen tuaj. Çfarë po ndodh me çmimin e karburantit? Sa herë mblidhet i ashtuquajtur i bordi i transparencës, çmimet e naftës pësojnë ulje dhe rriten vetëm një ditë më vonë, pavarësisht se çmimet në bursa pësojnë luhataje, duke pasur edhe ulje në disa prej tyre; ky bord nuk mblidhet kurrë në kohë për të marrë një vendim.

Kudo në Shqipëri fermerët po ankohen se kanë probleme të panumërta në lidhje me furnizimin e naftës pa akcizë. Disa ditë më parë Bashkia e Krutës u fajësua për përmytjen e tokave si pasojë e mungesës së pastrimit të kanaleve kulluese. Thoni se do të ndihmoni çdo fermer, por ndërkohë i lini nën ujë. E kuptoj se qeveria duhet të bëjë çdo gjë që të fshehtë medoemos të vërtetën, të fshehtë faktin se vendi po kalon një krizë, për të cilën ajo është përgjegjëse, sepse duhet të marrë vendime, që duhet të na nxjerrin nga kjo situatë e jo të na zhysin më poshtë.

Të dashur qytetarë, Një qeveri si kjo, e cila del para jush dhe deklaron se nuk ka çfarë të bëjë, se është në krizë, jo vetëm që është një qeveri e papërgjegjshme, neglizhente, por edhe e korruptuar deri në palcë. Këto nuk janë vetëm fjalët e mia, por janë edhe pjesë e raportit të DASH-it. Keni dalë duke thënë se do të jeni autokritikë. Me këtë gënjeni jo vetëm veten tuaj, por edhe qytetarët që ju shohin, të cilët i keni lënë në mëshirë të fatit; të rinjtë që po i detyroni të largohen dita-ditës, si dhe artistët dhe artin, të cilin e keni zhveshur nga çdo vlerë që duhet të kishte. Sot vërtet mendoj që duhet të flisni më shumë për ta, të diskutoni për politikën që do t'i ndihmojnë, por nuk mund të lë pa adresuar edhe problemet e situatës alarmante dhe atë që shquhet si fatkeqësia që rëndon sot mbi shqiptarët, ajo është vetëm qeveria e rilindjes. Ju falënderoj!